



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 539/6 Prot.

Durrës, më 10.02.2025

VENDIM

Nr. 11, datë 10.02.2025

PËR

**"MIRATIMIN E FORMATIT TË VETËVLERËSIMIT TË PERSONELIT
AKADEMIK, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës".**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së; të Vendimit të Rektoratit Nr. 2, datë 15.01.2025 pika 7; si dhe të shkresës Nr.166/4 prot., datë 29.01.2025 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 10.02.2025 Senati Akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës,

VENDOSI:

1. Miratimin e formatit të Vetëvlërësimit të Personelit Akademik, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Zv. Rektorët;
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore;
 - Drejtoria e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

